



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 983/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përbarimore të kreditorit Banka Ekonoimke, Sh.a., Prishtinë, Sheshi “Nëna Tereza” p.n., me numër unik identifikues 810485864, kundër debitorëve: 1. Digi Print Sh.P.K., rr. “Hajrullah Abdullahu”, nr.4, Prishtinë, me numër unik identifikues të biznesit 810844888, përfaqësuar nga K.ZH. me numër personal ... dhe Rr.Sh. me numër personal ..., në cilësinë e huamarrësit dhe penglënësit, 2. K.ZH., Lagja... Prishtinë me numër personal ..., në cilësinë e bashkë huamarrësit dhe penglënësit, 3. Rr.Sh., Rr. “....” Hyr., Prishtinë me numër personal ..., në cilësinë e bashkë huamarrësit dhe penglënësit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.1229/21 të datës 03.09.2021, i caktuar nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi, me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht prapësimi i debitorit të përbarimit “Digi Print” Sh.P.K , anulohet pjesërisht urdhri përbarimor P.nr.1229/21 i datës 03.09.2021 i përbaruesit privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë lidhur me detyrimin kryesor 5,736.91 € (pesëmijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë euro e 91 cent), dhe përfundohet pjesërisht procedura përbarimore lidhur me këtë pjesë.
- II. Refuzohet pjesërisht prapësimi i debitorit të përbarimit “Digi Print” Sh.P.K, mbetet në fuqi pjesërisht urdhri përbarimor P.nr.1229/21 i datës 03.09.2021 i përbaruesit privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, me të cilin është caktuar përbarimi për shpenzimet procedurale.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.1229/21 të datës 03.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin e propozuar në bazë të dokumentit Marrëveshje mbi pengun nr.207728, e datës 29.10.2019 për sigurimin e marrëveshje mbi kredinë për mbitërheqje nr.207728 e datës 29.10.2019, nr.277675 e datës 07.12.2020, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20210715-98 të datës 15.07.2021 me përfundim deri me datë 15.07.2024, i cili dokument paraqet dokument përmbartues në bazë të nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbartimor për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit mbi procedurën përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit mbi prokurimin dhe ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve. Në arsyetim të prapësimit kërkon nga gjykata aprovimin e prapësimit për arsye të vështirësive financiare në vitin e fundit të shkaktuara nga pandemia globale. Thekson se kjo gjendje e ka vështirësuar shumë ecurinë e biznesit. Andaj Gjykatës i propozon që pas shqyrtimit të prapësimit të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet Urdhri për përmbartim P.nr.2238/21 i datës 02.09.2021.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim, duke theksuar se vet debitorët deklarojnë se kanë pasur vështirësi financiare me çka nuk e kontestojnë as faktin se kanë rënë në vonesë në kthimin e kredisë meqë rast edhe kreditori është detyruar të inicioj procedurën përmbartimore për kthimin e borxhit. Lidhur me pretendimet se vështirësitë financiare kanë ardhur si pasojë e pandemisë Covid-19, thekson se kjo nuk duhet të shërbejë si arsye për vonesa në kthimin e kredisë për arsye se Banka Ekonomike konform dispozitave ligjore dhe udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë masave shtrënguese për menaxhimin e përhapjes së pandemisë të gjithë debitorëve të interesuar iu ka ofruar mundësinë e pezullimit të pagesës së kësteve dhe mos rënies në vonesë për kthimin e kredive të shfrytëzuara. Tutje shton se debitorët me vullnetin e lirë dhe pa kurrfarë presioni apo mashtrimi kanë nënshkruar marrëveshjen kreditore për mbitërheqjes për biznes me të cilën kanë marrë obligimet et caktuara si në nenin 3, 9 dhe 10 të marrëveshjes. Tutje shton se kuptohet se pretendimet e debitorëve janë të pabazuar në ligj, të pavërteta dhe se janë bërë vetëm për të zvarritur procedurën përmbartimore dhe shmangien nga obligimi që kanë ndaj kreditorit e i cili i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm Bankës. Gjykatës i propozon të refuzohet në tërësi prapësimi dhe të vazhdon procedura përmbartimore sipas urdhrin përmbartimor P.nr. 2238/21.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të prapësimit të ushtruar, me konkluzionin e datës 25.08.2023, nga debitori ka kërkuar që të deklarohet se ndaj cilit urdhër përmbarimor është ushtruar prapësim: urdhrit përmbarimor P.nr.1229/21 apo urdhrit përmbarimor P.nr.2238/21, pasi që debitori në prapësim i referohet urdhrit përmbarimor P.nr.2238/21.

Debitori me anë të parashtresës, me datë 06.09.2023, ka njoftuar Gjykatën se urdhri i atakuar me prapësimi është urdhri P.nr.1229/21, duke shtuar se pas parashtrimit të prapësimit ka përmbushur detyrimin, pra është përmbushur kredia dhe tani urdhri përmbarimor ka mbetur i pa lëndë. Tutje ka theksuar se kjo mund të konfirmohet edhe nga pala kreditore e cila është në dijeni për pagesën e detyrimit mbi të cilin është filluar procedura përmbarimore. Parashtresës i janë bashkangjitur një listë e pagesave dhe disa pagesa kombëtare të transferuara nga debitori tek kreditori.

Gjykata me qëllim të sqarimit të çështjes, me konkluzionin e datës 19.09.2023 ka ftuar kreditorin të njoftoj gjykatën nëse ende ekziston interesi juridik për vazhdimin e kësaj çështje, përkatësisht nëse debitori e ka përmbushur në tërësi detyrimin i cili është objekt i kësaj çështje përmbarimore.

Kreditore, me parashtresën e datës 19.09.2023 e ka njoftuar Gjykatën se debitori “Digi Print” Sh.P.K., e ka përmbushur borxhin e kredisë i cili është objekt i procedurës përmbarimore të lejuar sipas urdhrit përmbarimor P.nr.1229/21 të datës 03.09.2021. Kreditore, gjithashtu ka njoftuar Gjykatën se debitori nuk i ka paguar shpenzimet përmbarimore të cilat arrin shumën prej 686.09 euro. Andaj, Gjykatës i ka kërkuar që procedura të vazhdojë ndaj debitorit deri në mbylljen e tërësishme të borxhit, përkatësisht shpenzimeve përmbarimore të cilat arrin shumën prej 686.09 euro.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 66 par. 4 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i cili përcakton se: “*Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore*”, dhe duke vendosur sipas njoftimit zyrtar nga kreditore se detyrimi kryesor është përmbushur, këtë çështje përmbarimore e përfundoi pjesërisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës të shkaktuar me rastin e fillimi të procedurës përmbarimore, neni 13 para. 4 i LPP-së ka rregulluar se “*Përveç tarifës së efikasitetit të përmbarimit, e cila mund të përcaktohet me marrëveshje në mes të përmbaruesit privat dhe kreditorit, tarifatat tjera paraprakisht paguhen nga kreditore, dhe pas përfundimit të procedurës ato i ngarkohen debitorit*”. Sipas kësaj dispozite, Kreditore ka të drejtë në shpërblimin e shpenzimeve procedurale që i shkaktohen atij me qëllim që ta realizoj kërkesën e tij. Gjykata

rikujton se Kreditori në Propozim i kishte kërkuar shpenzimet procedurale, të cilat janë lejuar me Urdhër së bashku me kërkesën kryesore. Gjithashtu gjykata rikujton se Debitori e ka përmbushur vetëm kërkesën kryesore, por jo edhe shpenzimet procedurale, ndonëse me Urdhër ka qenë i obliguar që t'i paguaj edhe shpenzimet e procedurës. Nisur nga fakti i pa kontestuar ndërmjet palëve se Debitori obligimin e tij ndaj Kreditorit e ka përmbushur pasi ka filluar procedura përmbartimore, atëherë rrjedhë se fillimi i procedurës përmbartimore ka qenë i arsyeshëm, prandaj Debitori e ka për obligim që t'ia paguaj Kreditorit shpenzimet e krijuara, andaj edhe u vendos si në pikën II të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.983/22, datë 29.09.2023

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.